1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Njoftimin e Kontratës, Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....	
Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve	
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....	
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial	
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike	
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit	
Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve	
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit	
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....	
Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit.....	
Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)	
Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër	
Shtojca 13:Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)	

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit]**, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti), nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

SHËNIM:

Në këtë rast, në zbatim të Vendimit nr.710 datë 24.11.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet se: 5. Në nenin 45, “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje: “2.1 Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet, bazuar në:

a) çmimin e bursës, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftime Publike;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”.

Meqënëse çmimi i bursës, dhe elementët fiskalë janë të ndryshueshëm periodikisht, **oferta e OE do të jepet vetëm për normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute (në lekë për litër), e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.**

Sasitë e parashikuara nga AK në DST janë **sasi të pritshme** të bazuara mbi çmimin aktual të karburanteve për të pasqyruar nevojat reale dhe krijuar mundësinë e AK të parashikojë kriteret e kualifikimit dhe kapacitetet e nevojshme të OE ofertues për realizimin e kontratës (në këtë rast Marrëveshje Kuadër me afat 12 muaj).

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

Norma jonë e fitimit e shprehur në vlerë absolute (lekë për litër) është si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute (lekë për litër)	Afati i lëvrimit
1	Diezel (gazoil) karta/stikera (tollone elektronike – 10 p.p.m.		
2	Benzine pa plumb karta/stikera (tollone elektronike – 95 oct		

AK percakton se: Operatoret Ekonomike (OE), duhet te ofertojne vetem me 1 (nje) marzh fitimi per te dy llojet e karburantit.

Shënim:

Sasitë e kërkuara nga AK, janë **sasi të pritshme**, e llogaritur në bazë të çmimit të përcaktuar sipas Buletinit javor të publikuar nga APP dhe marzhit të fitimit marrë studimi i tregut aktual. Kjo sasi mund të

jetë e ndryshueshme në varësi të çmimit të publikuar nga APP në Buletinin javor dhe elementëve fiskalë të cilët janë periodikisht të ndryshueshëm.

Do të jetë AK ajo që do të përcaktojë **sasitë përkatëse** gjatë zbatimit të kontratës. OE do të ofertojnë me fitim në lekë për litër. Ky fitim do të jetë i pandryshuar gjatë gjithë realizimit të kontratave. Sasia e kërkuar nga AK është **sasi e pritshme**, për të cilën autoriteti do të shprehet në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Në ofertën për sasinë e pritshme për AK, çmimi i ofertuar do të jetë çmimi sipas Buletinit javor të publikuar nga APP dhe elementëve fiskalë, duke shtuar edhe çmimin e fituar për litër (i pandryshuar).

Fondi i Marreveshjes Kuader eshte: 8.073.450 (tetë milion e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) Leke pa TVSH.

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej **161.469 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Lek, pa TVSH.** [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi/ Vula**

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

DIEZEL (gasoil) 10 p.p.m

Vetitë	Njësitë	Kufizimet		Metoda Testi ^a
		Min	Max	(Shih 2. Referenca normative)
Numër Oktani Kërkimi, RON		95,0		EN ISO 5164 b
Numër Oktani Makine, MON		85,0		EN ISO 5163 b
Përmbajtje plumbi	mg/l		5,0	EN 237
Densiteti (në 15°C) c	kg/m ³	720,0	775,0	EN ISO 3675
				EN ISO 12185
Përmbajtje Sulfuri c	mg/kg		10,0	EN ISO 13032 EN ISO 20846 EN ISO 20884
Përmbajtje manganazi d	mg/l		2,0	EN 16135
				EN 16136

Qëndrueshmëria e oksidimit	min.	360		EN ISO 7536
Përmbajtja e gomës ekzistente (solvent i larë)	mg/100ml		5	EN ISO 6246
Rrip korrozioni bakri (3 h në 50 °C)	Vlerësim	klasi 1		EN ISO 2160
Dukshmëria e		I qartë dhe i ndritshëm		Inspektim vizual
Përmbajtja e tipit të hidrokarbonit c	% (V/V)		18,0	EN 15553
- Olefinë				EN ISO 228 54
- Aromatik			35,0	
Përmbajtja e benzolit c	% (V/V)		1,00	EN 238 EN 12177 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenit c	% (m/m)		3,7	EN 1601 EN 13132 EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenatit c	% (V/V)			EN 1601
				EN 13132
- Methanol f			3,0	EN ISO 22854
- Etanol g			10,0	
- Alkool Iso-propil			12,0	
- Alkol Iso-butyl			15,0	
- Alkool Tert-butyl			15,0	
- Eterë (5 ose më shumë atome C)			22,0	
- Oksigjenate h të tjera			15,0	
Produkti duhet te jete ne perputhje me standartin S SH EN 228: 2012 + A1:2017 (E)				

BENZINE pa plumb 95 oct

Vetitë	Njësitë	Kufizimet		Metoda Testi ^a (Shih 2. Referenca normative)
		Min	Max	
Numër Oktani Kërkimi, RON		95,0		EN ISO 5164 b

Numër Oktani Makine, MON		85,0		EN ISO 5163 b
Përmbajtje plumbi	mg/l		5,0	EN 237
Densiteti (në 15°C) c	kg/m ³	720,0	775,0	EN ISO 3675
				EN ISO 12185
Përmbajtje Sulfuri c	mg/kg		10,0	EN ISO 13032 EN ISO 20846 EN ISO 20884
Përmbajtje manganazi d	mg/l		2,0	EN 16135
				EN 16136
Qëndrueshmëria e oksidimit	min.	360		EN ISO 7536
Përmbajtja e gomës ekzistente (solvent i larë)	mg/100ml		5	EN ISO 6246
Rrip korrozioni bakri (3 h në 50 °C)	Vlerësim	klasi 1		EN ISO 2160
Dukshmëria e		I qartë dhe i ndritshëm		Inspektim vizual
Përmbajtja e tipit të hidrokarbonit c	% (V/V)		18,0	EN 15553
- Olefinë				EN ISO 228 54
- Aromatik			35,0	
Përmbajtja e benzolit c	% (V/V)		1,00	EN 238
				EN 12177
				EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenit c	% (m/m)		3,7	EN 1601
				EN 13132
				EN ISO 22854
Përmbajtja e oksigjenatit c	% (V/V)			EN 1601
				EN 13132
- Methanol f			3,0	EN ISO 22854
- Etanol g			10,0	
- Alkool Iso-propil			12,0	
- Alkol Iso-butyl			15,0	
- Alkool Tert-butyl			15,0	
- Eterë (5 ose më shumë atome C)			22,0	

- Oksigjenate h të tjera			15,0	
<i>Produkti duhet te jete ne perputhje me standartin S SH EN 228: 2012 + A1:2017 (E)</i>				

Gazoil, ne perputhje me Standardin Shteteror ne fuqi S.SH.EN 590 : 2013+A1:2017

Benzinë pa plumb, ne perputhje me Standardin Shteteror ne fuqi S.SH.EN 228 : 2012+A1:2017

Bashkelidhur me DST, do të keni standartin e publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit.

Specifikimi i Materialeve: **Specifikimet gjenden edhe bashkelidhur ketij dokumenti.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Furnizimi i mjeteve te transportit do te behet sipas sipas kerkesave te Institucionit perkates ne cdo ore te dites a te nates, gjate gjitha javes. Kontraktuesi se bashku me **Faturen e mallit** qe do te paraqitet per likujdim duhet te paraqese edhe **Flete analizat** per karburantet e kerkuar nga Autoriteti Kontraktor.
2. Kontraktori eshte i detyruar te respektoje kerkesat standarte lidhur me cilesine. Nese mbas furnizimit ne distributor, konstatohet se cilesia e *gazoilit (10 p.p.m.)* dhe *benzines pa plumb (95 oct)* nuk eshte sipas standartit, ai eshte i detyruar t'a zevendesoje ate me karburant me cilesi sipas standartit. Ne rast perseritje, Autoriteti kontraktor ka te drejte te nderprese kontraten dhe pergjegjesia do te jete e kontraktorit.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e pritshme e mallit që kërkohet:

Nr.	Emertimi i mallrave	Njesia	Sasia e pritshme
1	Diezel (gazoil) karta/stikera (tollone elektronike – 10 p.p.m	Litra	34 190 (tridhjetë e katër mijë e njëqind e nentëdhjetë)
2	Benzine pa plumb karta/stikera (tollone elektronike – 95 oct	Litra	19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë)

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Njesia	Sasia e pritshme	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Diezel (gazoil) karta/stikera (tollone elektronike) – 10 p.p.m	Litra	34.190	Per automjetet e IG	12 Muaj
2	Benzine pa plumb karta/stikera (tollone elektronike) – 95 oct	Litra	19.000	Per automjetet/ motomjetet e IG	12 Muaj

Shpjegim i termave: **IG-** Per AK Shoqerine “Illyrian Guard” Sh.A., Sauk Tirane (ushtrimi i aktivitetit te

AK ne te gjitha Qarqet e vendit)

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) Operatori Ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshiruar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuar të deklaratave për xhiron vjetore, për vitet financiare 2019 dhe 2020, ku vlera minimale e xhiros vjetore, të mos jete me e vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontrates që prokurohet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse OE arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Për të provuar përvojat e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, për një vlerë totale **jo më pak se 20% e vlerës së perlllogaritur të kontrates** që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar nga një Ent publik, OE duhet të paraqesë:
- Vërtetimin** e lëshuar nga Enti publik për permbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i perfundimit të kontratës, **ose**,
- Fatura tatimore** të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, të deklaruara në organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Paraqitja e njerit prej dokumentave të sipërcituara do të konsiderohet i mjaftueshëm.
- b) Kur furnizimet e mëparshme, të ngjashme, janë realizuar me sektorin privat, OE duhet të paraqesë si dëshmi **vetëm Fatura tatimore** të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe **të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2. OE duhet të jetë i pajisur me licencat perkatese, sipas objektit të prokurimit, **per tregtimin me pakice të karburanteve**, gazit të lengshëm të naftës, **per automjetet**, vajrave lubrifikante dhe lendeve djegëse **per perdorim nga konsumatorët fundorë**.

3. Subjekti ofertues duhet të ketë të paktën 1 (një) Stacion (**pike karburanti**) të tregtimit me pakice **në Bashkitë dhe Njesitë Administrative** poshteshenuar, vertetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale qeraje, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstratin tregtar të OE pjesmarres). Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice, detajuar sipas **Tabeles 1** të mëposhtme (Tiranë, Vlorë, Kukës, Pogradec, Elbasan, Durrës, Shkoder, Bashkia Vau Dejës, Lezhë, Krujë, Diber, Korçë, Berat, Fier, Lushnjë, Tropojë, Sarandë, Gjirokastrë) me të dhënat perkatese (vendndodhja, adresa/ person kontakti). Stacionet e tregtimit me pakice të karburanteve detyrimisht duhen të jenë të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

- Licence lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese lëshuar nga QKL;
- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Certificate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitje me pakice, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave;

Tabela 1

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja (adresa)	Person kontakti (Telefon)
1	Tiranë		
2	Vlorë		

3	Kukës		
4	Pogradec		
5	Elbasan		
6	Durres		
7	Tropoje		
8	Shkoder		
9	Diber		
10	Bashkia Vau Dejes		
11	Fier		
12	Lushnje		
13	Lezhe		
14	Sarande		
15	Gjirokaster		
16	Kruje		
17	Korçe		
18	Berat		

4. OE duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise **per vitin e fundit**.
5. Operatori Ekonomik duhet te paraqese Vërtetim teknik te leshuar nga ISHTI ose Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK, Leje mjedisore te tipit B, te leshuar nga QKL, Akt-Teknik te leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi lëshuar nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per depozitat e tregtimit me shumice qe verteton kapacitetet depozituese mbi **5.000 litra** lidhur me rezervat e OE, per te garantuar vazhdimesi ne furnizim, sipas kerkesave te autoritetit kontraktor.
6. Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si me poshte:
 - Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me **karte elektronike** te personalizuar me targa e cdo automjeti te Autoritetit Kontraktor ose bot, sipas kërkesave të ketij te fundit.

Karta elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri ne perfundimin e plotë të kontrates.

- OE duhet te mbuloje furnizimin nepermjet kartave elektronike te personalizuar, sipas adresave te kerkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar ne VKM Nr. 561 date 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e Qeverisjes se pergjithshme“ OE pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepemjet kartes elektronike.

Shënime:

- Sasitë e kërkuara nga AK, janë sasi të pritshme, e llogaritur në bazë të çmimit mesatar për litër nëpërmjet studimit të tregut dhe nga Buletini javor i APP-se. Kjo sasi mund të jetë e ndryshueshme në varësi të cmimit të publikuar nga APP në Buletinin javor.
- Do të jetë AK ajo që do të përcaktojë sasitë përkatëse gjatë zbatimit të kontratës. Operatorët do të ofertojnë me fitim në lek për litër. **OE duhet te ofertojne vetem me nje marzh fitimi per te dy llojet e karburantit.** Ky fitim do të jetë i pandryshuar gjatë gjithë realizimit të kontratave. Sasia e kërkuar nga AK është sasi e pritshme, për të cilën autoriteti do të shprehet në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Formulari i ofertës të përfshijë elemente si më poshtë:

- a) *çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftime Publike;*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.*

- Gjatë kohës së zbatimit të kontratës, për furnizimin me karburant, **vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë** gjatë ekzekutimit të kontratës në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant **Diezel (gazoil) 10 p.p.m., dhe Benzine super pa plumb 95 oct**, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.
- AK, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, Autoriteteve Kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori.

Referuar udhëzimeve te APP-se, per zerat ne DST qe mund te jete paraqitur marke/brand, OE mund te ofertojne **ekuivalente** te tyre gjate pergatitjes se ofertes ekonomike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I:**Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Përfaqësuesi (emri):	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____

B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
(nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:

formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
---	--

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën	Po []

në emër të ofertuesit;	
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).	Po [] Jo []
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me : a) çmimet;	Po [] Jo []

b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.	
9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	Po [] Jo []
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	Po [] Jo []

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose
